

**UPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-187/2014**

**Prishtinë,  
27 prill 2016**

Në çështjen juridike të:

**L. J.**

**Pala ankuese**

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Sylejman Nuredini, si kryetar i kolegjit, gjyqtarët Anna Bednarek dhe Beshir Islami anëtarë, duke vendosur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/A/220/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA35709), të datës 27 nëntor 2013, pas shqyrtimit të mbajtur më 27 prill 2016, mori këtë:

## AKTGJYKIM

1. Ankesa e paraqitur nga L. J. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/R/220/2013, e datës 27 nëntor 2013, refuzohet si e pabazuar.
2. Vërtetohet Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/A/220/2013, i datës 27 nëntor 2013 për sa i takon kërkesës së regjistruar në AKP me numër KPA35709.

### Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 13 prill 2007, L. J. (tani e tutje: pala ankuese) ka paraqitur kërkesë pranë Agjencisë Kosovare të Privatizimit, (tani e tutje: AKP) të regjistruar në AKP me numër KPA35709, me të cilën ka kërkuar ri-posedimin e ngastrës së tokës nr. 547 me sipërfaqe prej 00.07.60 ha, me lokacion në Livadnicë, zona kadastrale Radevë, e regjistruar në listën poseduese nr. 129 (tani e tutje: prona e kërkuar).
2. Pala ankuese ka deklaruar se babai i tij ka qenë bashkëpronar i (1/4 pjesë ideale) ngastrës së përmendur. Sipas palës ankuese persona të panjohur e kishin shfrytëzuar atë. Për këtë arsye ai ka kërkuar edhe kompensim për shfrytëzimin e saj. Pala ankuese shton se ka humbur posedimin e tokës më 10 qershor 1999.
3. Bashkë me kërkesën *ndër tjera* ka paraqitur:
  - Kopjen e vendimit të Gjykatës Komunale në Lipjan të lëshuar në lëndën nr. O.nr 12/83 më 1 qershor 1983, në bazë të cilit babai i palës ankuese: M. J. me 1/4 pjesë ideale dhe gjyshja e tij: S. J. me 1/5 pjesë ideale kanë trashëguar patundshmëritë që i ka lënë i ndjeri M. J.
  - Kontratën mbi ndarjen Ov.nr.868/83 të datës 26 korrik 1983, në bazë të së cilës babai i palës ankuese ishte bërë pronari i vetëm i pronës së kërkuar
  - Kopjen e certifikatës së vdekjes nr. 34 të vitit 1989 të gjyshit të palës ankuese: M.J.
  - Kopjen e certifikatës së lindjes së palës ankuese.
  - Kopjen e vendimit të Gjykatës Komunale në Kragujevc të lëshuar në lëndën nr. O-677/93 më 15 janar 2009 me të cilën ndryshohet vendimi i gjykatës së njëjtë i datës

- 17 maj 1994, në bazë të së cilit pala ankuese, i biri i tij N. J. dhe vëllai i tij G. J. kanë trashëguar 1/3 pjesë ideale të pronës së paluajtshme nga lista poseduese nr. 129 nga babai i tyre M. J.
4. Vendimi i lartpërmendur është verifikuar pozitivisht nga AKP-ja.
  5. Sipas raportit të verifikimit të datës 23 nëntor 2007 AKP-ja ka gjetur pronën e kërkuar. Prona është gjetur si tokë e kultivuar dhe e zaptuar nga persona të panjohur. Asnjë palë përgjegjëse nuk ishte e pranishme në pronë.
  6. Më 1 korrik 2010 AKP-ja ka bërë njoftimin e kërkesës përmes publikimit në Gazetën Zyrtare të AKP-së nr. 3 dhe në Buletinin e Zyrës Pronësore të UNHCR-së. Gazeta dhe lista mbeti te kryetari i fshatit Radevë. Ato u publikuan edhe në Komunën e Lipjanit dhe në Zyrën për Kadastër, që të dyja gjenden në lokale të njëjta me Gjykatën Komunale. Lista dhe Gazeta është shpërndarë te Selia e UNHCR-së, Avokati i Popullit, AKK, DRC dhe Zyra e UNMIK-ut në Graçanicë. Gjithashtu njoftimet ishin vendosur në hyrje të dhe në dalje të fshatit Radevë.
  7. Askush nuk ka paraqitur përgjigje në kërkesë.
  8. Gjatë procedurës së verifikimit AKP-ja *ex officio* ka gjetur CDPP nr. 547 që rendit P. J.(kushëririn e palës ankuese) si bartës të së drejtës pronësore të ngastrës së kërkuar.
  9. Më 27 nëntor 2013, KKPK-ja me vendimin e vet grupor KPCC/D/A/220/2013 (para. 12. 157-158) ka refuzuar kërkesën për faktin se pala ankuese nuk ka arritur ta dëshmojë pronësinë apo ndonjë të drejtë tjetër pronësore mbi pronën e kërkuar. Vendimi i AKP-së është bazuar në përmbajtjen e certifikatës së përditësuar mbi të drejtat e pronës së paluajtshme të siguruar *ex officio* in 2008 e cila e identifikon P. J.si pronarin e vetëm të ngastrës nr. 547. Përveç kësaj, në bazë të arsyetimit të vendimit, AKP-ja ka kontaktuar palën ankuese dhe ky i fundit ka sqaruar se ngastra e tokës nr. 547 i është falur kushëririt të tij P. J. para shumë kohësh dhe se nuk ka kërkuar të drejt pronësore mbi atë pronë.
  10. Vendimi i KKPK-së i është dorëzuar palës ankuese më 10 prill 2014.
  11. Më 10 maj 2014, pala ankuese ka paraqitur ankesë në Gjykatë Supreme.
  12. Me 30 qershor 2015, Gjykatata Supreme ka nxjerrë një urdhër për Zyrën Komunale Kadastrale të Lipjanit duke kërkuar “që ti ofroj Gjykatës dokumentacionin e plotë të historiatit të pronës” (...) si dhe që të shpjegoj faktin se në një zonë kadastrale

ekzistojnë dy parcela nën numrin e njëjtë por me sipërfaqe të ndryshme dhe me dy pronar (çka domethënë 547/D)”.

13. Me datë 15 korrik 2015 Zyra Kadastrale Komunale në Lipjan është përgjegjur në urdhër duke shpjeguar se në bazë të kërkesës së datës 20.06.2005 Zyra Kadastrale ka përmirësuar të dhënat të ofruara programit “Bomann” duke dhënë numër të ri: 546 për ngastrën e tokës me numër të mëparshëm 547 e cila përmendet në Fletën Poseduese No. 129

### **Pretendimet e palëve**

14. Pala ankuese L. J. kërkon që Gjykata Supreme ta pranojë ta pranojë ankesën e tij dhe të konfirmojë se ai është i autorizuar për ri-posedimin e pronës. Në ankesë ai pretendon se komisioni mbështetet në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe në zbatim të gabuar të ligjit material. Ai pohon se konstatimi i komisionit se P. J. është pronar i ngastrës 547/D nuk është i drejtë. Ai sqaroi se ngastra e tokës nr. 547 “më parë ishte ndarë në katër pjesë dhe dy pjesë të asaj ngastrë kanë shkuar te babai i tij dhe dy pjesë te axha i tij”. Ngastrat e babait të tij ishin shënuar në listën poseduese nr. 129, kurse ato të axhës së tij S.J. në listën poseduese nr. 40. Përveç kësaj, ai shton se edhe pse ngastrat e ndara ishin regjistruar nën numër të njëjtë, ato janë me sipërfaqe të ndryshme.

### **Arsyetimi ligjor**

#### *Meritat*

15. Gjykata Supreme, pas rishikimit dhe vlerësimit të parashtrësave nga shkresat e lëndës, të vendimit të apeluar dhe të pretendimeve të palës ankuese, gjen se ankesa është e pabazuar.
16. Komisioni ka bazuar mendimin e vet në supozimin se P. J. ishte pronari i pronës së kërkuar, siç është shfaqur në listën poseduese të siguruar ex officio më 2008 nga Sekretariati Ekzekutiv. Pala ankuese ka kundërshtuar këtë rrethanë dhe ka menduar se Gjykata Supreme e ka konsideruar si të domosdoshme ta sqarojë këtë rrethanë para së të vendoste mbi ankesën. Më 30 qershor 2015 Zyra Komunale për Kadastër

në Lipjan ka lëshuar urdhër me të cilin kërkohet sqarim shtesë i çështjes dhe historia e plotë kadastrale e pronës së kërkuar. Në përgjigje të këtij urdhri më 15 korrik 2015 Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër i kësaj Komune ka njoftuar se:

“Ngastra kadastrale nr. 547-0, ZK Radevë, sipas programit “Bormen” ishte shënuar në emër të S. (M.) J. nga Radeva, lista poseduese nr. 40, vendi i quajtur “Livadica”, tokë bujqësore, e klasës së III-të, me sipërfaqe prej 0.19.27 ha tokë bujqësore, e klasës së II-të, me sipërfaqe prej 0.27.27 ha. Në bazë të vendimit mbi trashëgiminë T. nr. 40/2003 të datës 12 maj 2003 (...) ajo ishte e regjistruar në emër të P. J. nga Radeva.

Ngastra kadastrale nr. 574-0, ZK Radevë, sipas programit “Bormen” ishte shënuar në emër të M.(M.) J. nga Radeva, lista poseduese nr. 129, vendi i quajtur “Livadica”, tokë bujqësore, e klasës së III-të, me sipërfaqe prej 0.18.46 ha dhe tokë bujqësore, e klasës së II-të, me sipërfaqe prej 0.07.60 ha, me sipërfaqe të përgjithshme prej 0.26.06 ha”.

Organi përgjegjës përveç kësaj shton se në përgjigje të kërkesës së datës 20 qershor 2005 Agjencia Kosovare për Kadastër korrigjoi të dhënat kadastrale dhe si rezultat ngastra e tokës 547-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 0.26.06 ha, e regjistruar në listën poseduese nr. 129 mori një numër të ri: 546-0. Listat e pjesshme poseduese nr. 129 dhe 40 janë dërguar pas përgjigjes.

17. Sidoqëtëjetë, duhet të theksohet se përgjegjja e autoritetit kadastral mundet që të mos konsiderohet si provë mbi fitimin e së drejtës së pronësisë në pronën e kërkuar nga ana e Ankuesit. Neni 17 i Ligjit Nr. 2003/25 të Kadastrit, i zbatuar tani në kohën kur ndryshimet në të dhënat kadastrale janë bërë, parashohin procedurën e cila duhet të ndjeket me qëllim të prezentimit të të dhënave në librat kadastrale. Neni 21 i Ligjit të njëjtë thekson se në cilat rrethana dhe si të dhënat në rgjister mund të përmirësohen. Sipas pikëpamjes së Gjykatës Supreme asnjëra nga dispozitat e sipërcekura nuk janë ndjekur me qëllim të ndryshimit të të dhënave në Kadastër. Për këtë arsye përgjigja e Zyrës Kadastrale në Lipjan nuk mundet që të mirret parasysh me rastin e shqyrtimit të Ankesës.

18. Pransaj, në këtë rast konkret Gjykata Supreme konsideron se Komisioni kë vepruar drejtë kur ka vendosur në lëndë, duke pasur parasysh paqartësinë e të dhënave (numrat e ngastrave) të përmbajtura në dokumentet e paraqitura për para Komisionit

- dhe Gjykatës, e drejta e pronës së ankuesit në lidhje me pronën e kërkuar nuk ka mundur që të jetë e bazuar. Në këtë rast Kërkesa duhet të refuzohet si e pabazë.
19. Bazuar në të mësipërmen dhe sipas nenit 13.3(c) të Ligjit Nr. 03/L-079 dhe Nenit 195 paragrafi 1 (d) të Ligjit të Procedurës Kontestimore, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi
20. Pasi Agjencia Kosovare e Pronës nuk ka juridiksion mbi kërkesat për kompensim, atëherë kërkesa e palës ankuese për kompensim duhet të hedhet poshtë si e papranueshme në bazë të nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut të përmendur më lart *a contrario*.

### **Këshillë juridike**

21. Në pajtim me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

**Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit**

**Anna Bednarek, gjyqtare e EULEX-it**

**Sylejman Nuredini, gjyqtar**

**Sandra Gudaityte, referente e EULEX-it**